



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
KRYETARI**

Nr. 526/7 Prot.

Tiranë, më 28/09/2018

V E N D I M

Nr. 140, Datë 28/09/2018

PËR

**AUDITIMIN E USHTRUAR NË DEGËN E DOGANËS DURRËS, “MBI
AUDITIMIN E PËRPUTHSHMËRISË DHE RREGULLSHMËRISË
FINANCIARE”**

për periudhën nga data 01.01.2017 deri më datën 31.12.2017.

Nga auditimi i ushtruar në Degën e Doganës Durrës, rezultoi që, ka mospërputhje në procedura; të meta e mangësi në zbatimin e legjislacionit dhe akteve administrative që rregullojnë funksionimin e institucionit në drejtim të procesit të vlerësimit e pranimit të deklaratave doganore të subjekteve të biznesit dhe individëve, objekt i veprimtarisë së doganave, të cilat kanë sjellë për pasojë mungesë të ardhurash për Buxhetin e Shtetit.

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Buxhetit të Shtetit, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të mësipërm, Drejtori i Departamentit Juridik dhe Kontrollit të Zbatimit të Standardeve të Auditimit dhe Etikës si dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 10, 15, 25 dhe 30, të ligjit nr.154/2014 miratuar në datën 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”,

VENDOSA

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit, “Për, vlerësimin nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet janë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator mbi bazën e të cilit e ushtron veprimtarinë”, të ushtruar në Degën e Doganës Durrës, sipas programit të auditimit nr. 526/1 prot., datë

11.05.2018, ndryshuar me: nr. 526/2 prot., datë 11.06.2018; nr. 526/3 prot., datë 27.06.2018 dhe nr. 526/4 prot., datë 18.07.2018, për veprimtarinë nga data 01.01.2017 deri më datën 31.12.2017.

II. Të miratoj rekomandimet për përmirësimin e gjendjes dhe të kërkoj marrjen e masave sa vijon;

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi. Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve, rezultoi se nga Autoriteti Doganor Kompetent: nuk është kryer kontabilizimin dhe kërkimin në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative, si dhe të gjitha shkallët e gjykimit me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerë prej në shumën **319,417 mijë lekë**, përcjellë me shkresën Nr. 1228/19 Prot, datë 03.07.2017, konstatuar nga veprime jo në përputhje me kërkesat e legjislacionit doganor; nuk janë zbatuar 2 masa organizative, si dhe nuk është filluar procedura e ecurisë disiplinore për vlerësimin e shkeljeve sipas pikës 1 të nenit 57 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të konsideruara nga ana jonë si shkelje të rënda e shumë të rënda, për shqyrtimin e dhënien e masave përkatëse sipas nenit 59 të ligjit nr. 152/2013, nga “mbajtja deri 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në 6 muaj”, deri “largim nga shërbimi civil” për 13 nëpunës civil, për shkeljet e konstatuar në kryerjen e detyrave funksionale, sipas Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 17-28 të Raportit të Auditimit.

1.1- Rekomandimi: Dega e Doganës Durrës në cilësinë e organit administrativ juridiksional dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave në cilësinë e organit epror, të analizojnë rekomandimet e pa realizuara, deleguar për kompetencë për vendimmarrje Degës Doganore Durrës duke marrë masa të menjëhershme për analizimin e shkaqeve dhe përgjegjësi konkrete ligjore për moszbatimin e tyre. Nga këto dy institucione të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme verifikuese dhe administrative ligjore në të gjitha shkallët e gjykimit për shpërblimin e dëmit të shumës prej 320,774 mijë lekë, rekomanduar më parë në Raportin Përfundimtar të Auditimit përcjellë me shkresën Nr.1228/19 Prot, datë 03.07.2017.

Deri më datën 30.11.2018

2.-Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i ushtruar mbi programimin dhe realizimin e të ardhurave doganore për periudhën objekt auditimi, u konstatua se DDD nuk ka realizuar të ardhurat doganore në krahasim me programimin e dërguar nga DPD, ku rezulton me mosrealizimin në vlerë 740,537 mijë lekë, veprim i cili tregon për punën e pamjaftueshme që ka kryer AD kompetent në përmbushjen e misionit në zbatim të legjislacionit doganor. AD nuk i ka analizuar dhe dokumentuar ato nëpërmjet përgatitjes së raporteve me shkrim për shkaqet e mos realizimit të të ardhurave dhe nxjerrjen e përgjegjësi individuale të secilit nga punonjësit e stafit doganor, sipas sektorëve dhe në përputhje me funksionet që ata kryejnë, veprime këto, jo në përputhje me kërkesat e nenit 9, pika 4, nenit 23 dhe 24 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”

Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 28-30 të Raportit të Auditimit.

2.1- Rekomandimi:- Dega e Doganës Durrës të rrisë bashkëpunimin me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave për studimin, hartimin dhe programimin gjatë fazës së planifikimit, me qëllim vendosjen e objektivave sa më real dhe në përputhje me aktivitetin e kësaj Dega Doganore. Autoriteti Doganor Durrës të bëjë një punë më të mirë duke zhvilluar më tej marrëdhëniet me subjektet, zbatimin me korrektësi të legjislacionit doganor me qëllim përcaktimin dhe analizimin e indikatorëve dhe faktorëve të ndryshëm ekonomikë për arritjen e këtyre objektivave

Në vijimësi

3.-Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se për subjektet të cilët kanë operuar në sektorin Porto Romano në kushtet e autorizimeve të Regjimit të Magazinave të Lira të “karburanteve”, nga krahasimi mes sasisë teorike të përfshirë në kontabilitetin e stokut dhe sasive reale të konstatuara nga administrata doganore, u konstatuan diferenca progresive dhe 3-mujore të artikujve të importuar dhe të depozituar në këto magazina, të cilave nuk u është dhënë destinacion doganor, veprime këto, jo në përputhje me kërkesat e nenit 11 Ligji nr. 61, datë 24.05.2012 “Për akcizat në RSH”, nenit 69.2 të VKM Nr. 612, datë 05.09.2012 “Për Dispozitat Zbatuese të Ligjit “Për Akcizat””, neni 190.1 ligji nr. 8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar. Gjithashtu, bashkëlidhur praktikave doganore, nuk ndodheshin çertifikata e verifikimit të llojit të mallit e emetuar nga Laboratori Doganor lidhur me verifikimin e mallit të importuar dhe deklaruar.

Më hollësisht trajtuar në pikën 4.5, faqe 117-135 të Raportit të Auditimit.

3.1- Rekomandimi:- Dega Doganore Durrës të marrë masa për rregullimin e situatës së gjendjes së mallrave në ambientet e magazinave të lira doganore, lidhur me dhënien e destinacionit doganor të mallrave, konform përcaktimeve në Aneksat nr.3 dhe nr.4 të dispozitave zbatuese të Ligji nr. 61, datë 24.05.2012 “Për akcizat në RSH” në njohjen e humbjeve nga frot natyrore dhe teknike, sipas normave ligjore për mallrat hidrokarbure.

3.2- Rekomandimi:- Dega Doganore Durrës të marrë masa që praktikant doganore të importit të karburanteve, të jenë shoqëruar me certifikatë analize nga autoritet shqiptare jo vetëm nga Inspektoriati Shtetërorë Teknik dhe Industrial, por edhe nga Laboratori Doganor.

Menjëherë

4.-Gjetje nga auditimi: Nga auditimi dhe analiza e borxhit doganor del se gjendja e borxhit në 31.12.2017 krahasuar me fillimin e vitit, është pakësuar me 77 raste ose 43 subjekte debitorë, ndërsa në vlerë është shtuar me 124,659 mijë lekë ose 3,7%. Gjatë vitit, borxhi është shtuar me 371,781 mijë lekë dhe është pakësuar me 247,122 mijë lekë. Nga Dega e Doganës Durrës nuk janë arritur të zbatohen plotësisht afatet ligjore të përcaktuara për rikuperimin e borxhit doganor, duke reflektuar një gjendje borxhi doganor në fund të periudhës së audituar në vlerën 23,480,333 mijë lekë.

Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 135-141 të Raportit të Auditimit

4.1- Rekomandimi: DDD, në bashkëpunim me DPD dhe institucione të tjera të përmendura në Udhëzimi nr. 4, datë 07.04.2016 të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave Tiranë “Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës”, të marrin masa konkrete dhe efektive nëpërmjet një programi të posaçëm për të zgjidhur në rrugë ligjore problemet që pengojnë rikuperimin e borxhit doganor në vlerën prej 23,480,333 mijë lekë, nëpërmjet krijimit të marrëveshjeve të reja me institucionet e tjera, për të bërë të mundur rikuperimin e borxhit doganor.

5. Gjetje nga auditimi. Nga auditimi i procedurave në zbatim të ligjit për akcizat rezultoi se operatorët ekonomik që operojnë në fushën e akcizës me statusin e depozituesit të miratuar nuk kanë kryer kalibrime për të gjitha depozitat e silloset me kapacitet mbajtës mbi 10 hektolitra si dhe nuk disponojnë kalimatësat në hyrje dhe dalje të produktit në depozita si dhe në pikën e shitjes, në kundërshtim me procedurën ligjore të shprehur në pikën 3/ç, neni 20, ligji nr. 61, datë 24.05.2012 “Për Akcizat në RSH”, si edhe me nenin 143, pika 1, germa “a” dhe “b”, dhe pika 14, të VKM nr. 612, datë 05.09.2012 “Për depozitat zbatuese të ligjit për akcizat”, i ndryshuar.

Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqe 141-145 të Raportit të Auditimit

5.1. Rekomandimi. Dega Doganore Durrës në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave me qëllim rregullimin e situatës së krijuar në zbatim të gërmës (ç) të pikës 3, neni 20 të ligjit nr. 61, datë 24.05.2012 “Për Akcizat në RSH”, të detyrojë depozituesit e miratuar duke kërkuar kalibrimin e gjithë depozitave, enëve dhe sillosëve si dhe kalimatësave në hyrje dhe dalje të produktit në depozita si dhe në pikën e shitjes dhe të aplikojë sanksione administrative sipas nenit 85 pika 1/a dhe nenit 96/1 pika 1, deri në revokimin e autorizimeve të dhëna nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për këta subjekte me status depozitues të miratuar.

Menjëherë

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Nisur nga gjetjet të trajtuara në Projektraportin e Auditimit, nga Dega e Doganës Durrës të kryhet kontabilizimi dhe të kërkohej në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për arkëtimin e të ardhurave të munguara **në Buxhetin e Shtetit për 2986 raste/subjekte, në shumën 385,885,145 lekë**, në mënyrë analitike sipas anekseve në faqe nr. 203-248 si më poshtë:

1.- Gjetje nga auditimi. Nga auditimi i dokumentacionit tregtar bashkëlidhur praktikave doganore IM4 dhe procedurave të ndjekura lidhur me deklarimin e mallrave, u konstatua: trajtim me transaksion i mallrave të importuar dhe shpenzimeve të transportit, veprime këto, jo në përputhje me kërkesat e Sesionit I dhe II të të Udhëzimit nr.25, datë 30.11.2007 të Ministrit të Financave “*Mbi procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore....*” në shkelje të neneve 35, pika 2, germa “a” dhe “b”; 36, pika 1, ndryshuar me nenet 67, pika 1, germa “d/i”; 70, pika 2, germa “a”; 70, pika 3 të Kodit Doganor; trajtimit me origjinë preferenciale të artikujve me deklaratë faturë, vlera e të cilëve e kalon shumën **6000 euro** si dhe artikujve të përdorur, veprime këto, jo në përputhje me kërkesat e: nenit 1, germa “I” Titulli I, neni 22 dhe neni 26, Titulli V, të Udhërrëfyesit të MSABE “*Mbi Rregullat e Origjinës Preferenciale të përdorura në tregtinë ndërmjet Shqipërisë dhe Vendeve të tjera sipas Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë*”; keqklasifikim i kodit tarifor të artikujve në kuadratin 31 dhe 33 të DAV me pasojë shmangien e detyrimeve doganore, veprime këto, jo në përputhje me kërkesat e neneve 256, pika 4; 261, pika 1, pika 2, ndryshuar me nenet 250, pika 4, 251, pika 2, germa “a”; 256, pika 1, germa “a” dhe “b”, të Kodit Doganor.

Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 30-77 të Raportit të Auditimit.

1.1- Rekomandimi: D.D.Durrës të marrë masa për kontabilizimin dhe zbatimin në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim arkëtimin e detyrimeve doganore **për 2378 raste**,

në vlerën **249,824,781 lekë**, referuar nenit: 28, pika 1 dhe 3, gërma “a”; 35, pika 2, gërma “a” dhe “b”; 36, pika 1; 256, pika 4; 261, pika 1, 2 dhe 3, të Ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar me nenet: 67, pika 1, gërma “d/i”; 70, pika 2, gërma “a”; 70, pika 3; 250, pika 4; 251, pika 2, gërma “a”; 256, pika 1, gërma “a” dhe “b”, të Ligjit nr. 102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”. (Në mënyrë të detajuar janë pasqyruar në anekset nr.: 3; 3.1; 3.2; 3.3; 3.4; 3.5; 3.6; 3.7; 3.8; 3.9; 3.10 dhe 3.11 të Raportit të Auditimit).

Deri më datën 30.11.2018

2.- Gjetje nga auditimi: Për subjektet të cilët kanë operuar në sektorin Porto Romano në kushtet e autorizimeve të Regjimit të Magazinave të Lira të “karburanteve”, nga krahasimi mes sasisë teorike të përfshirë në kontabilitetin e stokut dhe sasive reale të konstatuara nga administrata doganore, u konstatuan diferenca progresive dhe 3-mujore të artikujve të importuar dhe të depozituar në këto magazina, të cilave nuk u është dhënë destinacion doganor, veprime këto, jo në përputhje me kërkesat e nenit 11 Ligji nr. 61, datë 24.05.2012 “Për akcizat në RSH”, nenit 69.2 të VKM Nr. 612, datë 05.09.2012 “Për Dispozitat Zbatuese të Ligjit “Për Akcizat””, neni 190.1 ligji nr. 8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar. Në proces verbalin e inventarizimit fizik mungon dokumenti i llogaritje së humbjeve dhe firove të deklaruara nga subjekti dhe të verifikuara nga administrata doganore, veprime jonë përputhje me nenit 69.2 të VKM Nr. 612, datë 05.09.2012 “Për Dispozitat Zbatuese të Ligjit “Për Akcizat””.

Më hollësisht trajtuar në pikën 4.5, faqe 117-135 të Raportit të Auditimit.

2.1- Rekomandimi:- Dega e Doganës Durrës të marrë masa për zbatimin në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit **për 37 raste/subjekte**, në vlerën **85,412,496 lekë**. (Në mënyrë të detajuar janë pasqyruar në aneksin nr. 4.5 dhe nr. 4.6, të Raportit të Auditimit)

Deri më datën 30.11.2018

3.- Gjetje nga auditimi: Nga auditimi dhe shqyrtimi i dokumentacionit të praktikave doganore të operatorëve që kanë operuar nën mbikqyrjen doganore në regjimin e tranzitit (T1), rezultuan veprime jo në përputhje me kërkesat e nenit 119.1/a pasi nuk është respektuar afati i caktuar kohor për mbërritje në doganën e destinacionit. Nga doganieri i kontrollit dokumentar/fizik në pikën e kontrollit nuk është vepruar në përmbushje të detyrave funksionale në përputhje me kërkesat e nenit 285.3 ndryshuar me nenin 273.3 të KD, pasi nuk është mbajtur procesverbal konstatimi referuar nenit 256.2 dhe 260.b të KD, ndryshuar me nenin 257.1/b të KD.

Më hollësisht trajtuar në pikën 4.3, faqe 109-111 të Raportit të Auditimit.

3.1- Rekomandimi:- Dega e Doganës Durrës të marrë masa për kontabilizimin dhe zbatimin në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit për **486 raste**, në vlerën **33,210,000 lekë**. (Në mënyrë të detajuar janë pasqyruar në aneksin nr. 4.2 të Raportit të Auditimit)

Deri më datën 30.11.2018

4.- Gjetje nga auditimi: Nga shqyrtimi i dokumentacionit bashkëlidhur autorizimeve për regjimin e përpunimit aktiv të lëshuar për operatorë të ndryshëm ekonomik, u konstatua: tejkalim i afatit 30 ditor për mbylljen e regjimeve; shkelje të kufirit të rieksporrit; importe të

produkteve parësore të papërfshira në autorizim, si dhe dokumenti i mbylljes së regjimit ekonomik (mod.3) nuk rezulton të jetë miratuar nga kryetari i degës së doganës, për të cilat nga sektori i regjimeve nuk është mbajtur procesverbal konstatimi për shkeljet e sipërcituara. Për sa më sipër, është vepruar jo në përputhje me kërkesat e nenit: 256, pika 2; 275, pika 1 dhe 2; 272, pika 1 dhe 2; 285, pika 3, të Ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, nenit: 250, pika 4; 251, pika 1; 251, pika 2, germa “i”; 256, pika 1, germa “a” dhe “b”; 273, pika 3, të Ligjit nr. 102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, si dhe nenit: 6, pika 3; 15, pika 2, të Udhëzimit nr. 1, datë 06.09.2012, të D.P.D “Për zbatimin praktik të Regjimit të Përpunimit Aktiv”

Më hollësisht trajtuar në pikën 4.1, faqe 78-104 të Raportit të Auditimit.

4.1- Rekomandimi:- D.D.Durrës të marrë masa për kontabilizimin dhe zbatimin në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim arkëtimin e detyrimeve doganore për **42 subjekte**, në vlerën **6,824,990 lekë** referuar nenit 256, pika 2; 275, pika 1 dhe 2; 272, pika 1 dhe 2 dhe neni 285, pika 3 të Ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe nenit 250, pika 4; 251, pika 1; 251, pika 2, germa “i”; 256, pika 1, germa “a” dhe “b”, si dhe neni 273, pika 3 të Ligjit nr. 102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”. (Në mënyrë të detajuar janë pasqyruar në aneksin nr. 4 të Raportit të Auditimit)

Deri më datën 30.11.2018

5.- Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave mbi vendimet administrative të nxjerra nga autoriteti doganor kompetent për shkeljet në fushën doganore rezultoi se Autoriteti Doganor kompetent ka dalë me vendime administrative jo në përputhje të kërkesave nenit: 261, pika 1 dhe 2 të Ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; 256, pika 1, germa “a”, të Ligjit nr. 102/2014, “Kodi Doganor në Republikën e Shqipërisë”; 736 të VKM nr. 651, datë 10.11.2017 “Për Dispozitat Zbatuese të Ligjit nr. 102/2014, ‘Kodi Doganor në Republikën e Shqipërisë’, si dhe me pikën 1, germa “a”, “b”, “c” dhe “ç” të paragrafit V “Çështje specifike të lidhura me nenin 261 të KD” të Manualit Udhëzues nr. 5, datë 31.03.2016 të DPD, “Mbi zbatimin e dispozitave lidhur me shkeljet në fushën doganore dhe të akcizës”, lidhur me klasifikimin e shkeljeve në fushën doganore.

Më hollësisht trajtuar në pikën 7, faqe 145-155 të Raportit të Auditimit.

5.1- Rekomandimi:- Dega e Doganës Durrës të marrë masa për kontabilizimin dhe zbatimin në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit për **15 raste**, në vlerën **5,499,603 lekë**. (Në mënyrë të detajuar janë pasqyruar në aneksin nr. 7 të Raportit të Auditimit)

Deri më datën 30.11.2018

6.- Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave doganore të mbikëqyrjes së regjimeve ekonomike në kushtet e autorizimeve për magazinat doganore, u konstatuan mosmbyllje në kohë të regjimit sipas kriterëve të përcaktuara në autorizim, me pasojë të ardhura doganore të munguara në Buxhetin e Shtetit, veprime këto, jo në përputhje me nenin: 256, pika 2; 256, pika 4; 275, pika 1 dhe 2; 285, pika 3 të ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe nenin: 250, pika 4; 251, pika 1, 256,

pika 1, germa “a” dhe “b”; 273, pika 3, të Ligjit nr. 102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”.

Më hollësisht trajtuar në pikën 4.4, faqe 111-117 të Raportit të Auditimit.

6.1- Rekomandimi:- Dega e Doganës Durrës të marrë masa për kontabilizimin dhe zbatimin në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit për **12 raste**, në vlerën **4,148,360 lekë**. (Në mënyrë të detajuar janë pasqyruar në aneksin nr. 4.3 dhe nr. 4.4, të Raportit të Auditimit)

Deri më datën 30.11.2018

7.- Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave doganore gjatë mbikëqyrjes së regjimeve doganore të lejimit të përkohshëm të përjashtimit të plotë ose të pjesshëm, rezultuan veprime në mosrespektim të afateve të qëndrimit në mallrave në regjimin e lejimit të përkohshëm dhe mallrave të importuara nuk i'u është dhënë destinacion doganor nga subjektet përfitues të RLP, për të cilat nga sektori i regjimeve nuk është mbajtur procesverbal konstatimi për shkeljet e sipërcituara.

Më hollësisht trajtuar në pikën 4.2, faqe 104-109 të Raportit të Auditimit.

7.1- Rekomandimi:- D.D.Durrës të marrë masa për kontabilizimin dhe zbatimin në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim arkëtimin e detyrimeve doganore për **8 raste**, në vlerën **564,915 lekë** referuar nenit: 224, pika 1, 2 dhe 3; 250, pika 4; 251, pika 1; 259, pika 1, germa “a” dhe “b” dhe 273, pika 3, të Ligjit nr. 102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”. (Në mënyrë të detajuar janë pasqyruar në aneksin nr. 4.1 të Raportit të Auditimit)

Deri më datën 30.11.2018

8.- Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave në zbatim të ligjit për akcizat lidhur me operatorët ekonomik që operojnë në fushën e akcizës me statusin e depozituesit të miratuar rezultoi se: nuk kanë kryer kalibrime për të gjitha depozitat e silloset me kapacitet mbajtës mbi 10 hektolitra; nuk disponojnë kalimatësat në hyrje dhe dalje të produktit në depozita dhe në pikën e shitjes, në kundërshtim me procedurën ligjore të shprehur në pikën 3/ç, neni 20, ligji nr. 61, datë 24.05.2012 “Për Akcizat në RSH”, si edhe me nenin 143, pika 1, germa “a” dhe “b”, dhe pika 14, të VKM nr. 612, datë 05.09.2012 “Për dispozitat zbatuese të ligjit për akcizat”, i ndryshuar.

Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqe 141-145 të Raportit të Auditimit.

8.1- Rekomandimi:- Dega e Doganës Durrës të marrë masa për kontabilizimin dhe zbatimin në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit për **8 raste**, në vlerën **400,000 lekë**, referuar nenit 85, pika 1, germa “a” dhe nenit 96, pika 1, germa “a” të Ligjit nr. 61/2012, datë 24.05.2012 “Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. (Në mënyrë të detajuar janë pasqyruar në aneksin nr. 6 të Raportit të Auditimit)

Deri më datën 30.11.2018

C. MASA DISIPLINORE:

Mbështetur në nenin 59, pika 4, gërma “b”, të ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil” dhe pikës 11, Kreu II, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, kërkojmë të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore:

a. “mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në gjashtë muaj”; “pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet”; deri në, “Largim nga shërbimi civil” neni 58 gërma “b”, “c” dhe “ç”.

1. Për **z. M. B.**, me detyrë përgjegjës zyre në terminalin e kontenierëve, për problemet e konstatuara në kryerjen e detyrave funksionale sipas nenit 15.13 të Rregullores së Brendshme të Degëve Doganore nr. 19095/2 prot., datë 12.11.2012, lidhur me vlerësimin doganor si dhe zbatimin e grafikëve të shërbimit të pa miratuar nga Autoriteti Doganor;

2. Për **zj. A. C.**, me detyrë doganier klasifikim/vlerë, për problemet e konstatuara në kryerjen e detyrave funksionale sipas nenit 15.13 të Rregullores së Brendshme të Degëve Doganore nr. 19095/2 prot., datë 12.11.2012, lidhur me vlerësimin doganor, si dhe prezencën në punë jashtë grafikëve të miratuar nga Autoriteti Doganor;

b. “mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në gjashtë muaj” deri në “pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet”, neni 58 gërma “b” deri “c”.

3. Për **z. A. B.**, me detyrë doganier pikë kontrolli hyrje - dalje, për problemet e konstatuara në kryerjen e detyrave funksionale sipas nenit 15.11 të Rregullores së Brendshme të Degëve Doganore nr. 19095/2 prot., datë 12.11.2012, lidhur me regjimin e tranzitit;

4. Për **z. V. Dh.**, me detyrë doganier pikë kontrolli hyrje - dalje, për problemet e konstatuara në kryerjen e detyrave funksionale sipas nenit 15.11 të Rregullores së Brendshme të Degëve Doganore nr. 19095/2 prot., datë 12.11.2012, lidhur me regjimin e tranzitit;

5. Për **z. J. S.**, me detyrë doganier klasifikim/vlerë, për problemet e konstatuara në kryerjen e detyrave funksionale sipas nenit 15.13 të Rregullores së Brendshme të Degëve Doganore nr. 19095/2 prot., datë 12.11.2012, lidhur me trajtimin preferencial, keqklasifikimin e artikujve të deklaruar si dhe me vlerësimin doganor;

6. Për **z. N. B.**, me detyrë doganier klasifikim/vlerë, për problemet e konstatuara në kryerjen e detyrave funksionale sipas nenit 15.13 të Rregullores së Brendshme të Degëve Doganore nr. 19095/2 prot., datë 12.11.2012, lidhur me trajtimin preferencial, keqklasifikimin e artikujve të deklaruar si dhe me vlerësimin doganor;

7. Për **z. E. D.**, me detyrë doganier klasifikim/vlerë, për problemet e konstatuara në kryerjen e detyrave funksionale sipas nenit 15.13 të Rregullores së Brendshme të Degëve Doganore nr. 19095/2 prot., datë 12.11.2012, lidhur me trajtimin preferencial, keqklasifikimin e artikujve të deklaruar si dhe me vlerësimin doganor;

8. Për **z. E. P.**, me detyrë doganier klasifikim/vlerë, për problemet e konstatuara në kryerjen e detyrave funksionale sipas nenit 15.13 të Rregullores së Brendshme të Degëve Doganore nr. 19095/2 prot., datë 12.11.2012, lidhur me trajtimin preferencial, keqklasifikimin e artikujve të deklaruar si dhe me vlerësimin doganor;

9. Për **z. A. K.**, me detyrë doganier klasifikim/vlerë, për problemet e konstatuara në kryerjen e detyrave funksionale sipas nenit 15.13 të Rregullores së Brendshme të Degëve Doganore

nr. 19095/2 prot., datë 12.11.2012, lidhur me trajtimin preferencial, keqklasifikimin e artikujve të deklaruar si dhe me vlerësimin doganor;

10. Për zj. M. Z, me detyrë doganier klasifikim/vlerë, për problemet e konstatuara në kryerjen e detyrave funksionale sipas nenit 15.13 të Rregullores së Brendshme të Degëve Doganore nr. 19095/2 prot., datë 12.11.2012, lidhur me trajtimin preferencial, keqklasifikimin e artikujve të deklaruar si dhe me vlerësimin doganor;

11. Për z. J. S, me detyrë doganier klasifikim/vlerë, për problemet e konstatuara në kryerjen e detyrave funksionale sipas nenit 15.13 të Rregullores së Brendshme të Degëve Doganore nr. 19095/2 prot., datë 12.11.2012, lidhur me trajtimin preferencial, keqklasifikimin e artikujve të deklaruar si dhe me vlerësimin doganor;

12. Për z. K. B, me detyrë doganier klasifikim/vlerë, për problemet e konstatuara në kryerjen e detyrave funksionale sipas nenit 15.13 të Rregullores së Brendshme të Degëve Doganore nr. 19095/2 prot., datë 12.11.2012, lidhur me trajtimin preferencial, keqklasifikimin e artikujve të deklaruar si dhe me vlerësimin doganor;

13. Për z. B. Gj, me detyrë jurist, për problemet e konstatuara lidhur me konceptimin e vendimeve administrative, në kryerjen e detyrave funksionale sipas nenit 14.5 të Rregullores së Brendshme të Degëve Doganore nr. 19095/2 prot., datë 12.11.2012;

14. Për znj. E. S, me detyrë jurist, për problemet e konstatuara lidhur me konceptimin e vendimeve administrative, në kryerjen e detyrave funksionale sipas nenit 14.5 të Rregullores së Brendshme të Degëve Doganore nr. 19095/2 prot., datë 12.11.2012;

15. Për z. A. O, me detyrë dhe në cilësinë e ish përgjegjës së zyrës së klasifikim vlerësim kontroll fizik në terminalin e trageteve si dhe me cilësinë e ish përgjegjës të pikës së kontrollit të hyrje - daljeve, për problemet e konstatuara lidhur me vlerësimin doganor, klasifikimin tarifor dhe trajtimin me origjinë preferenciale të mallrave si dhe me regjimin e tranzitit, në kryerjen e detyrave funksionale sipas nenit 15.10 dhe 15.12 të Rregullores së Brendshme të Degëve Doganore nr. 19095/2 prot., datë 12.11.2012;

D. PËR PUNONJËSIT E LARGUAR.

Për ish punonjësit e mëposhtëm nuk rekomandojmë masa disiplinore edhe sepse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi personat e sipërpërmendur nuk janë në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien e zbatimit të tyre.

Nga ana jonë në bazë të shkeljeve të konstatuara masa disiplinore do të ishte **“mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në gjashtë muaj” deri në “pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet”, neni 58 gërma “b” deri “c”,** përkatësisht:

1. Për z. A. V, me detyrë dhe në cilësinë e ish doganier klasifikim vlerë;

E. NJOFTIMI I DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË MBIKËQYRJES TË SHËRBIMIT CIVIL

Për punonjësit të cilët janë rekomanduar masat disiplinore sa më sipër, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, **të ndërmarrë veprimet si më poshtë:**

a. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil", i ndryshuar.

b. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të ligjit nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil", i ndryshuar

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Shtetit. Ky vendim përcillet në formë rekomandimi në subjektin e auditimit.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R